



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Në mbështetje të LIGJIT Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS, si dhe LIGJIT Nr. 04/L-226 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS, neni 23 par.1 dhe 2, neni 28 paragrafi 1 pika 1.7, 1.11, neni 29, në mbështetje të STATUTIT të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës Nr. 04-V-312 të datës 02.03.2012, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës i përbërë nga: Valon Prestreshi, Kryetar i Komisionit të Konkurrencës, Ahmet Krasniqi, Zv. Kryetar, Fatime Haziri, Komisionere, Shaqir Morina, Komisioner, Muhamed Krasniqi, Komisioner, sipas kërkeses nga ana e Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronikë dhe Postare / ARKEP, në mbledhjen e mbajtur me dt. **2 Prill 2019** jep këtë:

MENDIM PROFESIONAL

Pas analizës dhe vlerësimit të rrethanave të rastit/gjendjes faktike, vlerësimit të Kontratës së Bashkëpunimit Afarist e lidhur ndërmjet "Kujtesa NET SH.P.K" ofrues i shërbimeve të caktuara në *tregun e telekomunikacionit dhe tregun e mediave*, dhe DARDAFON.NET LLC ofrues i shërbimeve të caktuara në *tregun e telekomunikacionit*, qëllimi i se cilës është bashkëpunimi afarist për futjen në treg të një produkti të përbashkët, për klient i njohur si "Kutiza" Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës;

Konstaton se,

Kjo formë e kontratës së bashkëpunimit, nuk bie ndesh me rregullat e konkurrencës në tregjet përkatëse, në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës,

Dhe, si e tillë;

Ka për qëllim që, vetëm për disa funksione të veçanta të tregut si shpërndarja, ofrimi i shërbimeve ose reklamimi, përmirësimin e sistemit të shitjes/distributimit të produkteve. Konsumatorët kanë benefit nga kjo formë e marrëveshjes, konkurrentëve apo konsumatorëve nuk ju obligohen kufizime, përmes së cilave arrihet ndonjë qëllim dhe nuk ka eliminim të konkurrencës në raport me pjesën tjetër të shërbimeve, rrjedhimisht nuk përbën kufizim apo ç'rregullim në vetvete.

ARSYETIM

Trajtimi i kësaj marrëveshje, është e formës si (Marrëveshje horizontale) që ka si objekt ose si pasojë racionalizimin ose specializimin e veprimtarisë ekonomike, kërkimin dhe zhvillimin e produkteve ose proceseve, shitjen e përbashkët të produkteve nga një burim i vetëm, e që si e tillë mund të përjashtohen nga ndalimi i përcaktuar në nenin 4 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës,

për shkak të eficiencës ekonomike, dhe se në kontratën e bashkëpunimit afarist ne mes Kujtesa Net.SH.P.K dhe Dardafon.Net L.L.C. në fjale nuk kemi kufizimi horizontal që do të rezultonte me kufizim të konkurrencës.

Nuk kemi elemente, që drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë, individualisht ose bashkërisht me faktorë të tjerë nën kontrollin e palëve kontraktuese, përmbajnë kufizime që kanë për qëllim:

- a) përcaktimin e çmimeve gjatë shitjes së produkteve tek palët e treta;
- b) kufizimin e prodhimit ose shitjes, apo
- c) ndarjen e tregut ose të blerësve

Ndërmarrjet, duhet t'i përgjigjen presionit konkurrues në rritje, ndryshimeve në treg që janë shkaktuar nga globalizimi dhe shpejtësia e zhvillimit teknologjik. Bashkëpunimi gjithashtu mund të ekzistojë në drejtim të ndarjes së rrezikut, reduktimit të kostos, bashkimit të njohurive dhe aftësive të nevojshme dhe zhvillim risi/inovacion. Bashkëpunimi është veçanërisht i rëndësishëm për bizneset e vogla dhe të mesme, për t'i përshtatur ato me ndryshimet në treg.

Pas asaj që u tha më lart, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës jep Mendimin e tij Profesional, nga pikëpamja e rregullave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

**KOMISIONI
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS**



Ahmet Krasniqi
Zv. Kryetar




Valon Prestesli
Kryetar

Fatime Naziri
Anëtare



Muhamed Krasniqi
Anëtar



Shaqir Morina
Anëtar

Me këtë Mendim Profesional, të njoftohet:

- ARKEP-it, **Ilir Imeri** Shef i Departamentit të Komunikimeve Elektronike
- Arhiva